

{Dial

JORGJI GJINARI

d GJUHA LETRARE, DREJTSHKRIMI DHE DIALEKTET E SHQIPES

Gjuha letrare kombëtare lind dhe formohet në periudhën kombëtare të historisë së një populli. Në këtë kohë vazhdojnë të jetojnë edhe dialektet që vijnë si mbeturina nga etapat e mëparshme të zhvillimit të gjuhës. Kështu, pas formimit të kombit, gjuha e një populli përbëhet nga dy variante kryesore, nga gjuha letrare kombëtare dhe nga gjuha dialektore (dialektet). Gjuha kombëtare në këtë kohë paraqitet si një tërësi me sistem të ndërlikuar ku përfshihen tiparet e përbashkëta që kanë gjuha letrare me dialektet, tiparet e veçanta të gjuhës letrare dhe gjithë veçoritë dalluese të dialekteve.

Gjuha letrare dhe gjuha dialektore kanë funksione shoqërore dhe sisteme të ndryshme. Ndërsa gjuha letrare kombëtare vepron si mjet komunikimi me një normë të vetme dhe të përbashkët për të gjithë anëtarët e shoqërisë, dialektet nuk kanë një normë të përbashkët, ato janë të kufizuara nga pikëpamja e përdorimit sipas territoreve ku gjenden. Përsa i përket sistemit gjuhësor ato kanë secila nga një sistem më vete, por, megjithatë, jo krejt të ndryshëm, sepse janë variante të një gjuhe. Gjuhën letrare e afrojnë me dialektet shumë tipare të njëjta që ekzistojnë në gjuhën kombëtare të gjithë popullit. Këto tipare të përbashkëta përbëjnë bazën themelore të gjuhës letrare. Madhësia dhe pesha e kësaj baze varen në radhë të parë nga shkalla e dallimit të dialekteve në periudhën e formimit të gjuhës letrare kombëtare. Sa më e vogël të jetë shkalla e dallimit të dialekteve, aq më e madhe është kjo bazë e përbashkët. Shqipja radhitet me ato gjuhë ku dallimet midis dialekteve nuk janë të mëdha.

Shtresa e përbashkët që formon bazën e gjuhës letrare nuk mund të konceptohet thjesht si një e tërë, që përbëhet vetëm nga ato tipare të gjuhës kombëtare që shfaqen si të njëjta edhe nga forma (nga ana e jashtme) edhe nga thelbi i tyre (nga funksioni), por edhe nga tipare të tjera, të cilat, edhe pse nga forma dalin si dallime, në thelb funksionojnë si të përbashkëta, të njëjta. Kështu në shtresën e përbashkët të gjuhës letrare kombëtare dallohen disa kategori tiparesh të njëjta.

Në kategorinë e parë hyjnë ato tipare të cilat edhe nga forma edhe në thelb paraqiten dhe funksionojnë si të përbashkëta; tiparet e kësaj kategorie që dallohen më lehtë janë të shumta në gjuhën e sotme letrare shqipe. P.sh., në sistemin leksikor: shumica e fjalëve përbërëse të gjuhës sonë letrare, në sistemin gramatikor: kategoria e

shquarësisë dhe kategoria e pashquarësisë bashkë me nyjet e prapme si mjete gramatikore, duke përfshirë edhe anën fonetike të tyre, sistemi i mbiemrave të nyjshëm, trajtat e përbashkëta të mënyrave dhe të kohëve në sistemin foljor etj. dhe në fonetikë: një numër shumë i madh i tingujve dhe i fonemave të përbashkëta, ndërrimi i zanores *i* të patheksuar me gjysmëzanoren *i* (variante të fonemës bashkëtingëllore *j*), p.sh.: *ziej-zjeva, i dha / ja dha, shkoi* (shkoi), *ftoi* (ftoi) etj., shumica e ndërrimeve fonetike të gjalla dhe historike, shqiptimi kudo i zanores *e* të patheksuar në rrokje të mbyllur nga një bashkëtingëllore sonante *r, rr, l, ll, m, n* (përtej, *motër, kokërr, i vogël, morëm, morën*) dhe rënja e saj kur rrokja kthehet në të hapur gjatë fleksionit (*motra, kokrra, i vogli*) e shumë të tjera.

Në kategorinë e dytë përfshihen ato tipare që nga ana e jashtme, nga forma, shfaqen si veçori dalluese, kurse në thelb funksionojnë në të vërtetë si tipare të përbashkëta. P.sh. shumë të folme të dialektit verior dallohen nga pikëpamja thjesht fonetike prej të folmeve të tjera të shqipes, sepse kanë disa tinguj zanorë që mungojnë në të folmet e tjera, por tinguj të këtillë në ato të folme funksionojnë vetëm si variante fonetike të fonemave përkatëse, kështu *a*-ja e përparme dhe e mbyllur (*ä*) si variante e fonemës *a* (*präp, lärg, mjäft*), *e*-ja e hapur (*e*) si variante e fonemës *e* (*vetlla, rrëth, viërr, hiëdh, dheu*), (*o*-ja e hapur e delabializuar *Λ*) si variante e fonemës *o* (*sat, ball, kas*), tingulli *o* (*e* e mbyllur e labializuar) si variante e *y*-së, atje ku ekziston kjo fonemë (*töm, rröp, möll, «mbyll»*), diftongoidi *ie* si variante e fonemës *e* (*lⁱesh «lesh», qⁱeth «qedh»*) etj.; një tipar i këtillë i përbashkët duhet parë edhe tek togjet e zanoreve *ua/ue, ye, ie*, sepse atje ku ekzistojnë këto togje janë të përbëra prej dy fonemash të veçanta, me përjashtim vetëm të tri të folmeve jugore (Devoll, Skrapar, Tepelenë), ku ato funksionojnë si diftongje nga pikëpamja fonetike dhe fonematike; po kështu, sot shihen dallime dialektore për rastet konkrete të përdorimit të bashkëtingëlloreve *nj* dhe *j*, sepse të folmet e Veriut, me përjashtime shumë të vogla, *nj*-në e kanë vetëm në fillim të fjalës (*njeri, njof,*) ndërsa në pozitë të tjera kanë *j* (*brija, punoj, ullij*), të folmet e skajit jugor të toskërishtes kanë *j* në pozitë fundore absolute, sidomos më tepër në sistemin foljor (*punoj, laj*), por, megjithatë bashkëtingëlloret *një* dhe *j* ekzistojnë kudo si fonema në opozicione të përcaktuara dhe, për më tepër, mungesa e *nj*-së në disa pozita të caktuara në këto të folme nuk shpjegohet me normat fonetike të folmeve të atyre të folmeve, por me ligje që kanë vepruar shumë kohë më parë e që nuk janë të gjalla sot.

Në kategorinë e tretë hyjnë ato tipare që nga ana thelbësore karakterin e tyre të përbashkët e shfaqin nëpërmjet prirjes së zhvillimit të tyre, p.sh. ndërrimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në të shurdhëta në një pozitë fundore absolute (*i madhi / i math*) që është karakteristikë qenësore e shumicës së të folmeve të dialektit jugor (me përjashtim të të folmeve të skajit jugor) dhe që del sporadikisht edhe në disa të folme të dialektit verior; ky ligj fonetik është ngushtuar prej kohësh dhe sot nuk vepron edhe në të folmet që e kanë si veçori shurdhimin, kjo duket qartë në rastet si: *plazh-i, garazh-i, të hy-*

ra vonë në gjuhën tonë dhe që shqiptohen kudo me bashkëtingëllore të zëshme dhe: *deg* (degë), *i bardh* (i bardhë), *lënd* (lëndë) etj., tek të cilat, edhe pse nuk ndihet zanorja ë fundore, bashkëtingëllorja nuk shurdhohet. E këtillë mund të konsiderohet dukuria e realizimit të zanoreve gojore përpara bashkëtingëlloreve hundore në gegërishten e sotme krahas rasteve me zanore hundore, p.sh.: *unë kam*, *ne lām*, *kemi*, *tona*, *jōn*, *atyne*, *oshtīm*, *veprim*, *shatrivan*, *kostum*, *revolucion* etj. Kjo dukuri që lidhet me bazën e artikullimit të sotëm të gegërishtes, e cila është pra si ajo e dialektit jugor dhe ajo e shqipes së sotme letrare, tregon se në këtë dialekt fonemat zanore hundore kanë mbetur në rastet ku janë krijuar që herët dhe nuk realizohen më në raste të tjera, ndryshe, p.sh., nga frengjishtja ku shqiptimi i zanoreve hundore përpara bashkëtingëlloreve hundore është një normë e gjallë, sepse në mënyrë tjetër nuk lejon baza e saj e artikullimit.

Tipare të përbashkëta të këtyre tri kategorive që u përmendën janë një realitet në stadin e sotëm të gjuhës kombëtare shqipe, pra edhe të gjuhës letrare të njësuar si variante e saj. Ky realitet gjuhësor i shqipes së sotme është pasqyruar përgjithësisht në mënyrë besnike edhe nga Rregullat e drejtshkrimit, sigurisht këtu fjala është për atë anë të normës drejtshkrimore që lidhet më tepër me formën e folur të gjuhës letrare, sepse, siç dihet, drejtshkrimi ka edhe anën tjetër që lidhet me formën e shkruar të kësaj gjuhe.

Veç shtresës bazë që përbëhet nga tiparet e përbashkëta, gjuha letrare kombëtare ka edhe një shtresë tjetër që formohet nga një numër veçorish dalluese të dialekteve. Elementet përbërëse të kësaj shtrese shkrihen organikisht në tërësinë e sistemit të gjuhës letrare si normë e saj. Kjo shtresë dialektore nuk formohet nga një përzierje mekanike e dialekteve, por kryesisht nga veçoritë qenësore e të përbashkëta të njërit prej dialekteve, të cilat përbëjnë atë që quhet bazë dialektore e gjuhës letrare kombëtare, dhe elemente që vijnë nga dialektet e tjera nëpërmjet bashkëveprimit dialektor. Raporti midis këtyre dy pjesëve përbërëse të shtresës dialektore që nuk është e njëjtë në gjuhë të ndryshme varet nga specifika e çdo gjuhe, nga tradita e shkrimit dhe nga faktorët shoqërorë që ndikojnë në periudhën e lindjes dhe formimit të gjuhës letrare kombëtare.

Gjuha letrare shqipe ka specifikën e vet, bashkëveprimi dialektor ka përfshirë të gjitha sferat e gjuhës duke kapur në një masë të vogël sistemin fonetik, në një masë më të madhe sistemin gramatikor dhe shumë më tepër sistemin leksikor, në këtë të fundit duke hyrë sidomos elemente nga të folme të veçanta e jo nga tiparet qenësore të përbashkëta të dialektit verior.

Edhe elementet që përbëjnë shtresën dialektore të gjuhës letrare duhen parë të lidhura me gjendjen e zhvillimit të dialekteve dhe të gjuhës kombëtare në stadin e sotëm, duke i dhënë rëndësi të dorës së parë edhe në këtë rast asaj që përbën thelbin e dukurisë.

Kështu në sistemin morfologjik të gjuhës letrare nuk ka hyrë trajta e paskajores e dialektit verior, por dihet se lidhorja është një trajtë që ekziston në të dy dialektet, edhe pse jo me një masë përdorimi të njëjtë. Gjuha e sotme letrare e njësuar ka si tipare në sistemin fonetik togun *ua* (*duar*, *mua*), grupin *va* (*vatër*, *vaj*) dhe format

me rotacizëm (*vera, dimri, hyra*). Këto u kundërvihen veçorive përgjegjëse të dialektit verior: togut *ue* (*duer, mue*), grupit *vo* (*votër, voj*) dhe *n-së* ndërmjet dy zanoreve (*vena, hyna*). Në thelb ky raport nuk është kaq i madh sa shihet nga ana e jashtme, sepse, siç u tha edhe më sipër togjet *ua/ue* në të dy dialektet sot funksionojnë si togje të përbërë nga dy fonema të veçanta *u, a* dhe *u, e*. Grupet *va* dhe *vo* gjenden sot në dialektet përkatëse në një numër të kufizuar fjalësh dhe kanë mbetur nga një kohë relativisht e hershme kur vepronin ligje që shkaktuan kalimin e togut *uo* në *ua*, në njërin dialekt, dhe në *uo*, në dialektin tjetër, si dhe zhvillimin e tyre të mëtejshëm në *va* dhe *vo* në një pozitë në fillim të fjalës. Ky proces sot nuk vepron. Pra këto dy grupe, jo vetëm sot, por as atëherë, nuk janë krijuar duke kaluar në Jug grupi *uo* në *va* dhe duke u ruajtur grupi *vo* (origjinar) në Veri ose duke kaluar grupi *va* në *vo*; me këtë shpjegohet prania e grupit *vo* krahas grupit *va* në dialektin jugor dhe në gjuhën letrare (*vaj*, dhe *i vogël*) dhe prania e grupit *va* krahas grupit *vo* në dialektin verior (*voj* dhe *vasha, varra*). Ky fakt ka rëndësi të madhe në raportin e sotëm që kanë dy dialektet e shqipes në këtë rast. Po ashtu edhe rotacizmi i *-n-së* ndërmjet dy zanoreve në dialektin jugor ka pushuar së vepruari qysh herët (krahaso: *vera* dhe *hëna, bëra* dhe *lanë*), për më tepër, është e rëndësishme se opozicioni fonologjik *r/n* sot ekziston në të dy dialektet dhe në gjuhën letrare. Në një masë të mirë me këtë shpjegohen ngritja e këtyre tipareve në normë të përbashkët letrare, qofshin ato me origjinë nga dialekti jugor, qofshin edhe ato me origjinë nga dialekti verior, gjithashtu ky fakt lehtëson edhe interferimin e tipareve të këtilla të gjuhës letrare në dialektet.

Në shtresën dialektore të gjuhës letrare ka edhe tipare të atilla për të cilat dallimi midis dy dialekteve të shqipes mbetet jo i vogël si në formë ashtu edhe në thelb, d.m.th. nga ana e funksionit. Të këtilla janë, p.sh., zanorja e theksuar ë që mungon në dialektin verior, fonema *y* të cilën nuk e kanë një numër i madh të folmesh të të dy dialekteve, mungesa e opozicionit fonologjik të zanoreve sipas gjatësisë, i cili ekziston në të gjithë dialektin verior dhe në pak të folme të dialektit jugor, grupet *mb, nd, ng, ngj*, shqiptimin e të cilave nuk e lejon baza fonetike e artikulimit në shumicën e të folmeve të dialektit verior.

Veç këtyre, në gjuhën letrare ka edhe tipare të tjera që në dialektet nuk janë krejtësisht të njëjta, por që janë ngritur në normë ose sepse kanë një përhapje më të madhe dialektore, si bashkëtingëlloret *h, rr*, ose sepse kanë hyrë me elementet e veçanta leksikore nëpërmjet bashkëveprimit, si bashkëtingëllorja *f* për bashkëtingëlloren *h* (*njoftoj*) etj.

Të gjitha këto elemente të shtresës dialektore janë një realitet gjuhësor në gjendjen e sotme të gjuhës letrare shqipe të njësuar. «Rregullat e drejtshkrimit» të vitit 1967, ndryshe nga ortografita e mëparshme, janë mbështetur më mirë në këtë gjendje objektive duke pasqyruar vetëm normën e njësuar kombëtare dhe jo dy variantet dialektore letrare, të cilat tashmë janë kaluar.

Duke qenë se drejtshkrimi pasqyron gjuhën e sotme letrare të

njësuar, e cila tashti paraqitet e formuar dhe e konsoliduar, nuk do të përligjshin, sidomos këtej e tutje, paragrafë të tij që të trajtonin disa tipare të bazës dialektore, si paragrafët për zanoren ë të theksuar, për togjet *ua, ye, ie* për grupet *mb, nd, ng, ngj* e ndonjë tjetër. Këta paragrafë janë gjurmë të ortografive të mëparshme që pasqyronin dy variantet dialektore letrare të gjuhës shqipe. Gjurmë të këtyre ortografive shihen edhe në disa paragrafë të tjerë.

Në ndonjë rast, kur në gjuhën letrare, sidomos në formën e folur të saj nuk është kristalizuar ende një normë e vetme, «Rregullat e drejtshkrimit» janë ngritur mbi realitetin gjuhësor të sotëm, kanë vendosur një normë drejtshkrimore duke u mbështetur në shtrirjen territoriale të dukurisë dialektore, në primaritetin e variantit dialektor nga pikëpamja kronologjike dhe në traditën e shkrimit të shqipes. E këtillë është, p.sh., norma drejtshkrimore për zanoren e të theksuar që ka qenë ndjekur ose që ndiqet sot nga një bashkëtingëllore hundore (*emër, zemër, ndenja, pe, fre, dre*).

Procese të këtilla do të kryhen derisa të kristalizohet plotësisht gjuha jonë letrare në formën e shkruar e të folur dhe në të gjitha stilet e saj. Sigurisht, edhe pas kësaj gjuha letrare do të pësojë vazhdimisht ndryshime të herëpashershme që lidhen me zhvillimin e saj të përndërprerë.

Pasi të arrihet kristalizimi i plotë i gjuhës letrare shqipe, do të jetë më e qartë se cilat elemente të dialekteve do të mbeten jashtë saj. Pikërisht veçori të këtilla dialektore që do të mbeten jashtë do t'i nënshtrohen veprimit ndikues të gjuhës letrare dhe do të «treden». Me sa duket, veçori si këto do të mbeten shumë edhe në të folmet e dialektit verior edhe në ato të dialektit jugor, sepse, si baza dialektore edhe gjithë shtresa dialektore e gjuhës letrare kurdoherë është shumë më e vogël se tërësia e veçorive dalluese të të folmeve të secilit dialekt.

Procesi i konvergimit të dialekteve me gjuhën letrare është i pashmangshëm, sepse kjo është prirja e vetme e zhvillimit dialektik të gjuhës në kushtet e kombit. Është e kuptueshme se kjo rrugë zhvillimi do të jetë e ndërlikuar dhe e gjatë.

Ritmet e këtij procesi varen nga faktorë të ndryshëm gjuhësorë dhe jashtëgjuhësorë. Roli dhe forca e faktorëve jashtëgjuhësorë janë të lidhur në radhë të parë me karakterin e sistemit shoqëror, sepse prej sistemit shoqëror varen shkalla e zhvillimit ekonomiko-shoqëror të krahinave të ndryshme të një vendi, shkalla e përhapjes së arësimi dhe kulturës në masat e gjera të popullit si dhe intensiteti i jetës politike-shoqërore të këtyre masave. Kjo shihet qartë edhe në ditët tona për gjuhën shqipe; kushtet e krijuara në kombin tonë socialist e kanë shpejtuar dhe do ta shpejtojnë çdo ditë e më tepër konvergimin e dialekteve në gjuhën letrare.

Pa dyshim, në këtë proces luan rolin e vet shumë të madh edhe një drejtshkrim i mbështetur mirë shkencërisht, një drejtshkrim që pasqyron mirë gjendjen reale e objektive të gjuhës letrare kombëtare në një stad të zhvillimit të saj.

